



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 6 prill 2021
Nr. Ref.:RK 1742/21

VENDIM PËR REFUZIM TË KËRKESËS

në

rastin nr. KI57/20

Parashtrues

Dile (Palushi) Bala

Vlerësim i kushtetutshmërisë së disa vendimeve të gjykatave të rregullta

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Dile (Palushi) Bala (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesja e kërkesës), të cilën e përfaqëson Avdi Rizvanolli, avokat nga Gjakova.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës vetëm i përmend tekstualisht disa vendime të gjykatave të rregullta, përkatësisht vendimet Rev. nr. 413/19, të 6 shkurtit 2020, Ac. nr. 4927/15, të 28 gushtit 2019 dhe C. nr. 327/12, të 16 shtatorit 2014), megjithatë të njëjtat vendime nuk i janë bashkëngjitur kërkesës.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuar, me të cilat parashtruesja e kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat e saj të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt gjyqësor] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesat individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 7 prill 2020, kërkesa u dorëzua (nëpërmjet postës) në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 19 maj 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (anëtarë).
7. Më 27 maj 2020, Gjykata njoftoi parashtruesen e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga e njëjta plotësimin e formularit dhe bashkëngjitjen e dokumentacionit mbështetës.
8. Më 15 dhjetor 2020, parashtrueses së kërkesës sërish i është kërkuar plotësimi i kërkesës dhe bashkëngjitja e dokumentacionit mbështetës.
9. Më 29 dhjetor 2020, përfaqësuesi i autorizuar i parashtrueses së kërkesës dorëzoi autorizimin e nënshkruar nga parashtruesja e kërkesës si dëshmi e përfaqësimit të saj në Gjykatë, megjithatë kërkesës nuk i ishte bashkëngjitur asnjë nga vendimet e përmendura në kërkesë.
10. Më 25 mars 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës, që ta refuzojë kërkesën me procedurë të shkurtër.

Përmbledhja e fakteve

11. Parashtruesja e kërkesës vetëm i përmend tekstualisht disa vendime të gjykatave të rregullta, me të cilat ajo pretendon se i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe KEDNj, megjithatë ato vendime nuk i janë bashkëngjitur kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

12. Parashtruesja e kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta shkelën të drejtat e saj të garantuara me nenet 31 dhe 54 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të KEDNj-së, sepse gabimisht vërtetuan gjendjen faktike dhe zbatuan të drejtën materiale në rastin e saj.

Pranueshmëria e kërkesës

13. Gjykata fillimisht shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
14. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], që përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara

[...]

15. Gjykata, në rrethanat e këtij rasti specifikisht i referohet nenit 22, paragrafit (4) të Ligjit, që përcakton:

“Nëse kërkesa ... nuk është e ... kompletuar, gjyqtari raportues njofton palët apo pjesëmarrësit përkatës për këtë dhe ia cakton një afat prej jo më shumë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve për të ... plotësuar kërkesën (...).”

16. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe i përgjigjeve], nënregullin (2) shkronja (h) dhe rregullin 35 [Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës], nënregullin (5) të Rregullores së punës, që përcaktojnë:

32 (2) “Kërkesa, po ashtu, duhet të përmbajë edhe:

[...]

(h) informacionet dhe dokumentacionin mbështetës.

[...]

35 (5) Gjykata mund të vendosë ta refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër në qoftë se kërkesa është e paplotë ose e paqartë, përkundër kërkesave nga Gjykata ndaj palës që të plotësojë ose të qartësojë kërkesën, (...)”.

17. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës pretendon që gjykatat e rregullta shkelën të drejtat e saj të garantuara me nenet 31 dhe 54 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të KEDNj-së, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të ligjit material.
18. Në zbatim të dispozitave të lartpërmendura, Gjykata nuk mund t'i marrë për bazë as faktet e rastit dhe as pretendimet e parashtrueses së kërkesës, për shkak se kërkesa është e paplotë, sepse asaj nuk i janë bashkëngjitur vendimet gjyqësore të kontestuar. (shih, Vendimin e Gjykatës Kushtetuese, në rastin K103/15, parashtrues *Hasan Beqiri*, të 13 majit 2015, paragrafët 14, 15, 17, 19, 20 dhe 21, si dhe rastin K107/16, parashtrues *Rifat Abdullahi*, të 14 korrikut 2016, paragrafi 22).
19. Gjykata, tentoi dy herë që të komunikonte me parashtruesen e kërkesës, për qëllime të plotësimit të kërkesës, megjithatë përveç autorizimit të dorëzuar nga përfaqësuesi i autorizuar i parashtrueses së kërkesës, asnjë dokument tjetër relevant nuk i është bashkëngjitur kërkesës.
20. Në këtë kontekst, Gjykata vlerëson se barra e përgjegjësisë për dështimin e kompletimit të kërkesës me dokumentacion mbështetës, bie mbi parashtruesen e kërkesës dhe përfaqësuesin e saj të autorizuar.
21. Si përmbledhje, Gjykata përfundon se kërkesa e parashtrueses së kërkesës nuk i përmbush kriteret formale për shqyrtim të mëtejshëm, për shkak të moskompletimit të saj me dokumentacion mbështetës.
22. Andaj, Gjykata, në pajtim me nenin 22.4 të Ligjit, me rregullin 32 (2) (h) dhe me rregullin 35 (5) të Rregullores së punës, përfundon se kërkesa e parashtrueses së kërkesës duhet të refuzohet me procedurë të shkurtër.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, të neneve 20 dhe 22.4 të Ligjit dhe të rregullave 32 (2) (h) e 35 (5) të Rregullores së punës, më 25 mars 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TË REFUZOJË kërkesën me procedurë të shkurtër;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtari raportues



Nexhmi Rexhepi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi